



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Për Shtyp

Rasti: Përfitim i kontrollit të shoqërisë Wellcomm Engineering S.p.A nga shoqëria Sirti S.p.A.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i blerjes së shoqërisë Wellcomm Engineering S.p.A nga shoqëria Sirti S.p.A.

Referuar “Propozim Kontrate për shitblerjen e aksioneve” palët në marrëveshje janë:

Pala Blerëse: Sirti S.p.A është një shoqëri aksionere e regjistruar sipas legjislacionit italian. Blerësi është aktiv kryesisht në ofrimin e shërbimeve inxhinierike civile dhe kontrollohet në mënyrë të tërthortë nga fondi investimeve KKR & Co.L.P

Pala Shitëse: Z.Nino Piero Maria Marsanasco , Z.Mauro Brena, Znj.Maria Stella Brena dhe Z.Gianpietro Rognoni .

Shoqëria target: Wellcomm Engineering S.p.A, është shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit Italian me objekt veprimtarie: prodhues kompjuterash dhe pajisje hyrëse dhe dalëse (input dhe output), programim kompjuterik, konsulencë dhe veprimtari të ngjashme dhe instalime të tjera ndërtimi etj.

Wellcomm Engineering S.p.A, kontrollon shoqërinë Sicab Telecomunicazioni, e fokusuar në zhvillimin e teknologjive të komunikimit IT, shoqërinë We Consulting (pjesë të transaksionit) specializuar në sektorin e sigurisë së të dhënave dhe aplikacioneve dhe shoqërinë Zerbion S.r.l (që nuk është pjesë e transaksionit).

Më datë 21 dhjetor 2018, është nënshkruar “Propozim Kontrate për shitblerjen e aksioneve”, nga shoqëria blerëse Sirti S.p.A dhe katër shitësit , shtetasit italian.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.